

Kurti kërkon zgjedhje të parakohshme

FAQE 3

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka kërkuar të martën zgjedhje të parakohshme. Ai ka bërë me dije se Vetëvendosje do ta mbështesë çfarëdo mocioni për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKA E RE", RRAHMAN JASHARAJ

FAQE 4-5

Greva është e pashmangshme nëse nuk reflekton Qeveria



Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se kjo sindikatë nuk ka hequr dorë nga greva e përgjithshme në arsim e paralajmëruar më 13 prill nëse

Qeveria nuk reflekton deri të premten. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai e ka ftuar Qeverinë ta vendosë në rend të ditës Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Kosovë dhe ta procedojë për

në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që të parandalohet greva. Sipas Jasharajt, përgjegjësinë për këtë grevë do ta marrin institucionet e Kosovës, të cilat që pesë vjet nuk kanë plotësuar kërkesat e tyre

AKTUALE

PËRVEÇ DEKLARATËS UNIVERSALE TË KB-SË PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE KONVENTAVE EVROPIANE, KOSOVËS NUK I DUHET ASGJË TJETËR F. 6

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



VESEL: DOKTOR HAFIR SHALA ISHTE MJEKU I PLAGËVE TË PARA TË LUFTËTARËVE TË UÇK-së F. 11

GJYLJETA MUSHKOLAJ: KUSHTETUTA E KOSOVËS NUK E NDALON BASHKIMIN ME SHQIPËRINË F. 3

AKKVK-ja, institucion që ofron ndihmë për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit

Profesori Mensut Ademi në tetor të vitit 2009, së bashku me disa bashkëpunëtorë, ka themeluar Asociacionin e Kriminologëve, Kriminalistëve dhe Viktimologëve të Kosovës (AKKVK) që aktualisht ka rreth 800 anëtarë. Këtë asociacion nga viti 2009 e deri më tani e drejton vetë Ademi, i cili ka treguar se synimi i AKKVK-së është të arrijë deri te politikat strategjike nacionale dhe ndërkombëtare për parandalimin

dhe luftimin e kriminalitetit, si dhe të ofrojë programe për parandalimin e dukurive kriminale si delikuenca e të miturve, frika nga kriminaliteti, terrorizmi, radikalizmi, konfliktet në familje dhe rehabilitimi i personave gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas vuajtjes së dënimit. Ademi ka bërë me dije për "Epokën e re" se AKKVK-ja ka bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare



EKONOMI

PARALAJMËROHET HAPJA E NJË BANKE PËR DIASPORËN NË KOSOVË F. 9

ASK-ja: ÇMIMET E KONSUMIT SHËNUAN RITJE F. 8

KULTURË

HARADINAJ PREMTON PËRKUJDESJE PËR INFRASTRUKTURËN E BIBLIOTEKAVE F. 14

SPORT

BATATINA: GARA PËR TITULL ENDE NUK KA PËRFUNDUAR F. 18

RENOVA
PUTZ
Magdioni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Presidenti Thaçi, pjesëmarrës në Samitin e Sofjes

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka njoftuar se ka biseduar me telefon me kryeministrin bullgar për Samitin e Sofjes i cili për Kosovën është një shans i ri i avancimit të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian



PRISHTINË, 10 PRILL - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka njoftuar se ka biseduar me kryeministrin e Bullgarisë, shtet ky që kryeson Presidencën e BE-së. Thaçi në një postim në "Facebook" ka shkruar se samiti i Sofjes për Kosovën është një shans i ri i avancimit të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian. "Sapo zhvillova një bisedë telefonike me kryeministrin e Bullgarisë, Boyko Borisov, shtet ky që aktualisht kryeson Presidencën e Bashkimit Evropian. Ne biseduam për Samitin e Sofjes, i cili është i rëndësishëm për rrugëtimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE", ka thënë Thaçi. Ai ka shtuar se konfirmuam që do të takohemi shumë shpejt për koordinimin të agjendës sonë bilaterale dhe asaj euroatlantike. "Unë theksova nevojën e qartësimit të perspek-

tivës evropiane për Kosovën si parakusht për krijimin e një dinamike të re për përmbushjen e kriterëve të nevojshme për anëtarësim të plotë në BE. Samiti i Sofjes për Kosovën është një shans i ri i avancimit të marrëdhënieve me Bashkimin Evropian. Ishte qëndrim i për-bashkët që duhet të vazhdojë dialogu për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, si një domosdoshmëri për sigurimin e paqes afatgjatë në Ballkanin Perëndimor", ka shkruar presidenti Thaçi në Facebook. Ditë më parë kryeministri i Spanjës, Mariano Rajoy, i kishte thënë homologut të tij bullgar, Boyko Borisov, se ai mund të mos shkonte nëse pjesëmarrës ishte presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Bullgaria, si kryesuese e radhës e Këshillit të BE-së, ka vënë prioritet afrimin e Ballkanit

Perëndimor me BE-në dhe për këtë ka organizuar samit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor në Sofje të Bullgarisë. Kontesti me Spanjën është pasqyruar këtë javë edhe në mediet e Bullgarisë, por edhe në ato të Brukselit. Javën e kaluar mediet lokale në Kosovë kanë raportuar se Bashkimi Evropian dhe Bullgaria si kryesuese, i kanë bërë ftesë presidentit Thaçi për pjesëmarrje në këtë samit. Kjo ftesë shihet se është nënshkruar nga presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, nga presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker dhe nga kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borisov. Bullgaria, e cila aktualisht mban Presidencën e Këshillit të BE-së, do të presë në muajin maj udhëheqësit e 27 vendeve të BE-së dhe të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

LAJME SHKUR

Rama: Opozita po tallet me protestën e tregtarëve

TIRANË, 10 PRILL - Kryeministri Edi Rama ka treguar të martën për protestën e organizuar nga tregtarët kundër rritjes së taksave. Në një reagim në "Facebook", Edi Rama shprehet se protesta është organizuar nga politikanët e opozitës dhe arsyet se përse janë ftuar njerëzit t'i mbyllin qepenat nuk ka të bëjë me taksat. Ai thotë se politikanët e opozitës janë tallur me qytetarët, pasi tregtarët që punojnë në tregje nuk janë pjesë e skemës së TVSh-së. Ndryshe nga sa deklarojnë deputetët e opozitës, se taksat e reja do të falimentojnë biznesin, Edi Rama thotë se Qeveria e tij e ka çuar në zero taksën për biznesin. "Protesta e uljes së qepenave në tregjet bashkiake, tallje e madhe me njerëzit nga politikanët pa atdhe! Sepse tregjet janë jashtë skemës së TVSh-së! Ne bëmë zero taksën e biznesit të vogël dhe futja në TVSh e të vegjëlve nuk rrit aspak barrën mbi ta, po siguron kontrollin e të mëdhenjve", deklaroi Rama.

Të martën tregtarët e pesë tregjeve kryesore në Tiranë mbyllën qepenat e bizneseve për një orë. Protesta është reagim për futjen e biznesit të vogël në skemën e TVSh-së. Pjesë e protestës ishin edhe deputetët opozitarë të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integritim.



Bashkëpunimi Shqipëri - Kosovë për diasporën

TIRANË, 10 PRILL - Ministri i Diasporës i Kosovës, Dardan Gashi, së bashku me homologun shqiptar Pandeli Majko, zhvilluan një takim me përfaqësues të rrjetit të bizneseve shqiptare në Zvicër dhe Gjermani. Në fokus të këtij takimi ishte krijimi i kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve nga diaspora. Të dy ministrat e diasporës, i Shqipërisë dhe i Kosovës, i informuan të pranishmit lidhur me bashkëpunimin e dy shteteve për ta trajtuar diasporën si një të tërë dhe përpjekjet që po bëhen për ta mundësuar shfrytëzimin e efektshëm të potencialit jashtë vendit. Duke e vënë theksin te numri i lartë i sipërmarrësve shqiptarë në Zvicër, Gjermani, por edhe në vendet e tjera të botës, Majko pranoi rolin jetësor që do të kishin investimet në rritjen ekonomike. Ai pranoi sfidat e mëdha me të cilat përballen për t'u garantuar sipërmarrësve një ambient të favorshëm.

Nga ana e tyre, përfaqësuesit e bizneseve kërkuan mbështetjen e dy qeverive për identifikimin dhe regjistrimin e sipërmarrësve shqiptarë në Zvicër dhe Gjermani. Të dhënat, sipas tyre, do t'u vijnë në ndihmë jo vetëm atyre, por edhe shteteve.

Sipërmarrësit folën për projektet dhe investimet e bëra në vendet e origjinës, gjithashtu për kontributin e dhënë për sigurimin e bursave për studentët shqiptarë.



Ministri grek Kocias viziton Ballkanin

ATHINË, 10 PRILL - Ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kocias, nis një turne diplomatik në Serbi, Kosovë dhe Maqedoni. Vizitat e tij në Prishtinë dhe Beograd zhvillohen sot (e mërkurë), ndërsa takimi i tij me homologun maqedonas Nikola Dimitrov do të mbahet nesër (e enjte) në Ohër.

Në Prishtinë Kocias do të takohet me zëvendëskryeministrin

Enver Hoxhaj dhe ka shumë mesazhe për të dhënë. Por Athina konfirmon se është ende herët për të pasur bisedime për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Kryediplomati grek ka shprehur optimizëm se takimi i tij me Dimitrov do të jetë një hap i madh për zgjidhjen e çështjes së emrit. Nëse do të ketë zhvillime pozitive në Ohër, pritet

shumë shpejt një takim mes kryeministrit Aleksis Cipras dhe Zoran Zaev.

Në lidhje me emrin e Maqedonisë, burime diplomatike bëjnë me dije se Athina mund të bëjë një hap prapa për ndryshimet kushtetuese të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ku Kocias po përpiqet të gjejë një zgjidhje të mesme.



Kurti kërkon zgjedhje të parakohshme

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka kërkuar të martën zgjedhje të parakohshme. Ai ka bërë me dije se Vetëvendosja do të mbështesë çfarëdo mocioni për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj. Sipas Kurtit, kjo Qeveri ka rënë moralisht, por duhet të bjerë edhe me numra. Ndërkaq drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se shkuarja në zgjedhje pa ndryshime zgjedhore dëmton konsolidimin e shtetit dhe demokracisë

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 10 PRILL - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, të martën ka kërkuar zgjedhje të parakohshme, si dhe ka shprehur përkrahje për mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë Haradinaj. Ai ka vlerësuar se mbetja e kësaj Qeverie në pushtet është dhunim i demokracisë, vullnetit të popullit dhe interesit të përgjithshëm. "Lëvizja Vetëvendosje është për zgjedhje të parakohshme parlamentare sa më parë dhe për mocion për rrëzimin e Qeverisë. Shumica dërmuese e popullit dhe shumica e deputetëve të Kuvendit janë në opozitë me këtë Qeveri. Mbetja e kësaj Qeverie në pushtet është dhunim i demokracisë qytetare e parlamentare, i vullnetit të popullit e i interesit të përgjithshëm. Nuk mund të mbetet shteti e populli peng as të qejfit të kryeministrit dhe as të frikës së presidentit", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se janë dhjetëra arsye për të cilat Qeveria Haradinaj duhet të shkojë në shtëpi. Madje, sipas Kurtit, kjo Qeveri ka rënë moralisht, por duhet të bjerë edhe me numra. "U bënë katër javë prej se Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka shprehur qëndrimin e saj

se kjo Qeveri ka rënë moralisht dhe ajo duhet të bjerë edhe me numra. Nenad Rikallo e Milan Radojčić, shtimi enorm i posteve qeveritare dhe rritja e pagave vetvetes, diskreditimi i arsimit tonë nga BE-ja dhe rritja e papunësisë, Contour Global dhe 'Demarkacioni', e deri te dëbimi tinëz, në shkelje të ligjit e të drejtave të njeriut i gjashtë shtetasve turq, përgjegjësinë për të cilin nuk po e merr asnjë institucion i Kosovës, janë vetëm disa prej arsyeve pse kjo Qeveri e shtrenjtë duhet të largohet. Interpelancat për temat e ndryshme dhe komisionet hetimore parlamentare që kemi iniciuar janë dëshmi e opozitarizmit tonë dhe dëmeve të kësaj Qeverie që duhet të shkojë", ka deklaruar Kurti.

Zgjedhje të parakohshme ka kërkuar edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Deputeti i kësaj partie, Naser Rugova, ka bërë me dije se do t'i marrin masat e nevojshme që sa më shpejt kjo Qeveri të shkojë në shtëpi. Sipas Rugovës, LDK-ja më tepër se kurrë është e përgatitur për t'i filluar bisedimet për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. "LDK-ja është lokomotiva e opozitarizmit në Kuvend dhe si partia më e madhe në vend do t'i përdorim të gjithë mekanizmat kushtetues dhe ligjorë në mënyrë që këtë Qeveri të papërgjegjshme



ta largojmë nga pushteti. Deri më tani është dëshmuar se LDK-ja është partia më serioze në shtetndërtimin e Kosovës. Do të bëjmë çmos që ta ndërpresim fundosjen e vendit prej kësaj Qeverie. Nën drejtimin e këtij koalicioni qeverisës Kosova ka ngecur në të gjitha aspektet. Duke i respektuar kompetencat kushtetuese dhe ligjore do ta dërgojmë në shtëpi këtë Qeveri. Do t'i marrim masat e nevojshme që këtë qeveri të papërgjegjshme ta dërgojmë në harresën e historisë së Kosovës sepse e ka dëmtuar vendin, proceset si dhe ka rrënuar imazhin e shtetit. LDK-ja nuk do të jetë pjesë e kësaj Qeverie të papërgjegjshme. LDK-ja më tepër se kurrë është e përgatitur t'i fillojë bisedimet për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja. Vetëm atëherë do të kemi Qeveri dhe institucione legjitime nga vullneti i popullit të Kosovës", ka deklaruar Rugova për gazetën "Epoka e re".

Kryeziu: Shkuarja në zgjedhje pa ndryshime zgjedhore dëmton konsolidimin e shtetit

Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se marrëveshja politike në mes të opozitës dhe pozitës për shkuarje në zgjedhje të parakohshme pa ndryshimet zgjedhore, është qasje dëmtuese kundrejt konsolidimit të shtetit dhe demokracisë. Sipas tij, para marrëveshjeve për zgjedhje, partitë politike duhet të bëjnë marrëveshje për një sërë ndryshimesh zgjedhore, për çka dhe ekziston një draftdokument nga viti 2014-2015, në të cilin bëjnë pjesë: listat zgjedhore, zonat, fletëvotimet, pragu etj.", ka shkruar Kryeziu në llogarinë e vet në "Facebook".

elita, të nxitura nga korrupsioni politik. Prandaj në secilën situatë, përfshirë marrëveshjet politike në mes të opozitës dhe pozitës për shkuarje në zgjedhje të parakohshme pa ndryshimet zgjedhore, është qasje dëmtuese kundrejt konsolidimit të shtetit dhe demokracisë. Para marrëveshjeve për zgjedhje, partitë politike duhet të bëjnë marrëveshje për një sërë ndryshimesh zgjedhore, për çka dhe ekziston një draftdokument nga viti 2014-2015, në të cilin bëjnë pjesë: listat zgjedhore, zonat, fletëvotimet, pragu etj.", ka shkruar Kryeziu në llogarinë e vet në "Facebook".

Gjyljeta Mushkolaj: Kushtetuta e Kosovës nuk e ndalon bashkimin me Shqipërinë

PRISHTINË, 10 PRILL (ER) - Me rastin e dhjetëvjetorit të Ditës së Kushtetutës së Kosovës, Kolegji AAB dhe Instituti për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare (ISKIP) kanë mbajtur tryezë tematike me temën "10 vjet Kushtetutë".

Të pranishëm në këtë tryezë ishin personalitetet e drejtësisë në Kosovë si dhe anëtarët e Komisionit për Hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Anëtarja e komisionit për hartimin e Kushtetutës, Gjyljeta Mushkolaj, ka thënë se

Kushtetuta e Kosovës nuk e ndalon që Kosova të bashkohet me Shqipërinë. "Kushtetuta shumë qartë në të vërtetë e ndalon që Kosova të kërkojë të bashkohet me një shtet tjetër ose pjesë të ndonjë shteti tjetër me të cilën bashkësia ndërkombëtare na ka vendosur një lloj kufiri që ne të mos kemi pretendime territoriale në Maqedoni dhe Serbi. Në anën tjetër, nëse dikush tjetër na bën ftesë, pra nëse një ftesë të tillë na bën Shqipëria, neve na mbetet të vendosim se a dëshirojmë apo jo të bashkohemi", ka thënë Mushkolaj.



Flet për "Epoka e re", Rahman Jasharaj

Greva është e pashmangshme

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka bërë me dije se kjo sindikatë nuk ka hequr dorë nga greva e përgjithshme në arsim e paralajmëruar më 13 prill nëse Qeveria nuk reflekton deri të premten. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai e ka ftuar Qeverinë ta vendosë në rend të ditës Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Kosovë dhe ta procedojë për në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që të parandalohet greva. Sipas Jasharajt, përgjegjësinë për këtë grevë do ta marrin institucionet e Kosovës, të cilat që pesë vjet nuk kanë plotësuar kërkesat e tyre

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 PRILL - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka thënë se greva e përgjithshme e paralajmëruar për 13 prill në arsim është e pashmangshme nëse Qeveria nuk e plotëson kërkesën e tyre. Ai e ka ftuar Qeverinë e Kosovës që deri të premten ta vendosë në rend të ditës Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Kosovë dhe ta ndalë grevën e paralajmëruar.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jasharaj ka thënë se askush në sindikatën që drejton nuk e do grevën, por është Qeveria ajo që duhet të veprojë e të reflektojë si duhet. "Nëse deri më 13 prill Qeveria nuk reflekton



Shefi i AKI-së ia konfirmon dorëheqjen Haradinajt

PRISHTINË, 10 PRILL - Shefi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Driton Gashi, ia ka ofruar dorëheqjen e kërkuar kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinajt. Lajmin e ka konfirmuar për "Radion Evropa

e Lirë" zëdhënësja e Qeverisë së Kosovës, Donjeta Gashi. Dorëheqja e Gashit vjen pas vendimit të kryeministrit Haradinaj për lirim nga detyra e shefit të AKI-së si dhe ministrit të Brendshëm Flamur Sefaj, pas debimit të

gjashtë shtetasve turq nga Kosova, më 29 mars. Emërimi i drejtorit të AKI-së bëhet nga presidenti dhe kryeministri i Kosovës dhe ai shërben si këshilltar për siguri i të dy zyrtarëve shtetërorë.



nëse nuk reflekton Qeveria



dhe nuk i jep dritë të gjelbër Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës dhe nuk e procedon për në Kuvend atëherë do të fillohet më 13 prill me grevën në kohë të pacaktuar, gjegjësisht deri në realizimin e kërkesave të anëtarësisë së SBAShK-ut", ka thënë Jasharaj.

Ai ka deklaruar se përgjegjësinë për grevën do ta mbajë Qeveria që deri më tani nuk e ka marrë seriozisht kërkesën e tyre. "Historiku i këtij ligji daton që nga prilli i vitit 2013 kur Kuvendi ka debatuar për të dhe ka autorizuar MASHT-in që brenda tre muajve ta përgatisë këtë ligj dhe ta dërgojë në Kuvend. Ja u bënë plot pesë vjet nga ajo kohë dhe ligji ende nuk është proceduar në Kuvend. SBAShK-u ka pritur mjaft", është shprehur ai.

Jasharaj nuk ka dashur të flasë për ndikimin që mund të ketë kjo grevë në testin PISA-s dhe atë të maturës. "Ne ua kemi bërë me dije edhe përmes shkresave zyrtare institucioneve se nëse fillon greva atëherë nuk ka mësim e as ndonjë aktivitetet tjetër. Këtë alarm e kemi bërë edhe përmes medieje gjithnjë duke alarmuar Qeverinë të veprojë dhe të reflektojë. Qeveria mund dhe duhet të veprojë pa ardhur 13 prilli", është shprehur Jasharaj.

"Epoka e re": Z. Jasharaj, SBAShK-u ka paralajmëruar grevë më 13 prill në të gjitha shkollat e Kosovës. Keni hequr dorë nga kjo grevë?

Jasharaj: Jo, nuk kemi hequr dorë. Duhet të sqaroj se në SBAShK-u për veprime sindikale, pra për greva nuk vendos individë, po janë organet e SBAShK-ut ato që vendosin. Konkretisht Kongresi i SBAShK-ut, më 24 shkurt, veç të tjerash, delegatët nga të gjitha komunat e Kosovës dhe nga universitetet e kanë votuar një rezolutë për veprime sindikale dhe ajo është obligative për kryetarin

dhe për kryesinë. Kjo rezolutë ka saktësuar se nëse deri më 13 prill Qeveria nuk reflekton dhe nuk i jep dritë të gjelbër Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës dhe nuk e procedon për në Kuvend atëherë do të fillohet më 13 prill me grevën në kohë të pacaktuar, gjegjësisht deri në realizimin e kërkesave të anëtarësisë së SBAShK-ut. Qeveria duhet të reflektojë dhe ta vë në rend dite këtë projektligj sa nuk ka ardhur 13 prilli, në të kundërtën i tërë sistemi arsimor në Kosovë do të jetë në grevë dhe për këtë përgjegjësinë e kanë institucionet që nuk po veprojnë, edhe pse kanë pasur mjaft kohë për këtë. Historiku i këtij ligji daton që nga prilli i vitit 2013 kur Kuvendi ka debatuar për të dhe ka autorizuar MASHT-in që brenda tre muajve ta përgatisë këtë ligj dhe ta dërgojë në Kuvend. Ja u bënë plot pesë vjet nga ajo kohë dhe ligji ende nuk është proceduar në Kuvend. SBAShK-u ka pritur mjaft.

"Epoka e re": Keni pasur takim me ministrin Bytyqi për këtë çështje dhe cili ka qenë qëndrimi i tij?

Jasharaj: Po, kemi pasur takim me ministrin Bytyqi. Ai ka kërkuar mirëkuptim nga ne, duke thënë se është mirë të mos ketë grevë, por ne i kemi treguar se greva nuk është dëshirë e jona. Kemi pritur mjaft kohë dhe i kemi dhënë hapësirë të mjaftueshme dialogut, por ja që dialogu nuk ka dhënë asnjë rezultat dhe se greva është vendim i Kongresit. Askush nuk mund të ndryshojë a mohojë një vendim të tillë.

"Epoka e re": Cilat janë kërkesat e juaja?

Jasharaj: Kërkesa jonë kyçe është që Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip dhe të Republikës së Kosovës të jetë në rend dite në takimin e Qeverisë dhe të pro-

cedohet në Kuvend. Kemi edhe kërkesat që të jemi të angazhuar në komision për përgatitjen e Ligjit për pagat dhe për Ligjin e punës. Jam i sigurt se edhe do të jemi të përfshirë në këto komisione dhe se do të dëgjohen e aprovohen kërkesat tona.

"Epoka e re": Tani fillon testi Pisa, po ashtu edhe Testi i maturës. Mund të ndikojë greva në këto procese të rëndësishme?

Jasharaj: Ne ua kemi bërë me dije edhe përmes shkresave zyrtare institucioneve, se nëse fillon greva atëherë nuk ka mësim e as ndonjë aktivitetet tjetër. Këtë alarm e kemi bërë edhe përmes medieje, gjithnjë duke alarmuar Qeverinë të veprojë e të reflektojë. Qeveria mund dhe duhet të veprojë pa ardhur 13 prilli.

"Epoka e re": Këshilli i Prindërve të Kosovës ka kundërshtuar paralajmërimin e juaj për grevë, me arsyetimin se me këto veprime po pësojnë më së shumti fëmijët. Keni menduar për pasojat që mund t'i ketë greva?

Jasharaj: Ne as edhe një herë nuk e kemi dashur grevën dhe për këtë i kemi dhënë hapësirë dialogut dhe takimeve me institucionet. Opinioni e di se edhe veprimet sindikale i kemi bërë deri tani të përshtatshme, greva njëorëshe, pastaj greva dyorëshe pas disa ditësh, pastaj më 12 mars greva njëditëshe e duke i dhënë kohë Qeverisë nga 12 marsi deri tani të veprojë. Do të ishim njerëzit më të lumtur sikur Qeveria tani të vepronte duke i dhënë dritë të gjelbër Ligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës para se do të vijë 13 prilli dhe në këtë mënyrë do të na hiqej të gjithëve një barrë kaq e rëndë. SBAShK-u nuk i ka dashur e as nuk i do grevat, por është Qeveria ajo që duhet të veprojë e të reflektojë si duhet.

Ligji për kryeqytetin kalon në Komisionin për Administratë

PRISHTINË, 10 PRILL - Në Komisionin për Administratë Publike dhe Qeverisje Lokale të martën ka kaluar Ligjin për kryeqytetin dhe për polici të kryeqytetit. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i

Prishtinës, Shpend Ahmeti. "Sot në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media të Kuvendit të Republikës ka kaluar Ligji për kryeqytetin bashkë me amandementin për polici të krye-

qytetit. Ky ligj është esencial për funksionimin edhe më të mirë të kryeqytetit tonë. Së shpejti pritet vota përfundimtare në seancën plenare", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



Zvicra do ta përkrahë Kosovën në zhvillimin e arsimit profesional

EPOKA E RE**Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 10 PRILL - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet, me të cilin ka biseduar për zhvillimet në fushën e arsimit dhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në këtë sektor, me theks arsimin dhe aftësimin profesional.

Ministri Bytyqi e ka falënderuar ambasadorin për mbështetjen që Zvicra ka bërë në shtetndërtimin e Kosovës, në veçanti në reformimin e sistemit të arsimit, njëherësh ka shtruar nevojën e mbështetjes së mëtutjeshme. "Ne kemi nevojë për përkrahjen tuaj, sidomos për ngritjen e cilë-

sisë dhe për zhvillimin e arsimit dhe aftësimin profesional, që t'i përvetësojmë modelet tuaja të zhvillimit të mësimin dual, përkatësisht ndërlidhjen e mësimin teorik dhe praktik", ka thënë Bytyqi.

Ai ka theksuar se mungon një shtrirje adekuate e shkollave profesionale në rajone, e që po e vështirëson zhvillimin e punës praktike të nxënësve, por edhe zhvillimi i profileve të reja, adekuat me nevojat e tregut të punës. Po ashtu, ministri Bytyqi ka theksuar angazhimin e MASHT-it që nga klasa 6-9 t'i identifikojë nxënësit, të cilët do të orientohen në arsimin e mesëm profesional apo atë të përgjithshëm.

Ndërsa ambasadori Jean-Hubert Lebet ka thënë se Zvicra do të vazhdojë ta mbështesë



zhvillimin e arsimit në Kosovë, sidomos zhvillimin e arsimit profesional. "Ju keni nevojë për një arsim që do ta mundësojë

punësimin e të rinjve që ata të mos orientohen në migrim, por që shanset e tyre t'i kërkojnë dhe krijojnë në Kosovë", ka deklaruar

ar Lebet, duke theksuar se tashmë është hartuar një strategji e re, e cila do të zbatohet deri në vitin 2020.

Nis agjenda e përbashkët qeveri-komuna për tejkalimin e sfidave

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 10 PRILL - Çështjet buxhetore, çështjet pronësore që ndërlidhen me tokat dhe ato që ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit, janë temat kryesore për të cilat Qeveria dhe komunat duhet të bashkëpunojnë. Kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në takimin e parë me kryetarët e komunave në kuadër të "Forumit konsultativ qeveri - komuna", i iniciuar nga vetë kryeministri.

Ky takim është cilësuar si hap i parë drejt ndërtimit të platformës së përhershme të konsultimit, bashkëpunimit dhe bashkërendimit në forumin konsultativ qeveri - komuna. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se ky është një fillim i mirë i zhvillimit të një konsulte të vazhdueshme, pra një Këshill Konsultativ të vazhdueshëm qeveri-komuna, pasi kryetarët e komunave janë në komunikim me qytetarët të cilët presin prej tyre. Ai ka thënë se puna e



kryetarëve të komunave është shumë e vështirë pasi pritet dhe nevojat janë të mëdha, ndërsa mundësitë janë të kufizuara.

Duke përmendur disa prej çështjeve dhe temave me të cilat ballafaqohen komunat e Kosovës, kryeministri Haradinaj ka pohuar se problemet janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato buxhetore, për të cilat tha se duhet krijuar një marrëdhënie e re për tejkalimin e sfidave të rënda në disa komuna.

"Mundësitë që ekzistojnë duhen zbatuar dhe jo të humben për shkak të mungesës së komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet nivelit nacional dhe atij lokal. Takimi i sotëm është një nismë e nevojshme për ta vendosur këtë partneritet në të mirë të qytetarëve", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se komunat e kanë partnere Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, por edhe Zyra e Kryeministrit dëshiron të jetë e

kyçur në çështjet me të cilat ballafaqohen komunat e Kosovës dhe t'u dalë në ndihmë për zgjidhjen e tyre dhe për këtë arsye, Qeveria tashmë ka caktuar koordinatorin Besnik Tahiri që do të merret me këto tema.

Kryeministri ka vlerësuar se dhënia e pronave në shfrytëzim për komunat është një tjetër hap drejt zhvillimit ekonomik. Ai ka përmendur edhe luftën kundër korrupsionit, për të cilën ka thënë se është interes i Kosovës

dhe i bashkësisë ndërkombëtare, në procesin e reformave evropiane dhe çështjen më të ndjeshme të vendit tonë, liberalizimin e vizave për qytetarët tanë.

Ndërkaq, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se Ministria e Financave është në dispozicion të komunave. "Çdoherë kur ato kanë nevojë për alokime, rialokime dhe për aprovim të të hyrave shtesë, do të jenë të hapur në çdo kohë", është shprehur Hamza.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, njëherësh kryetar i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, ka vlerësuar lart organizimin e këtij takimi, duke thënë se pushteti lokal ka disa probleme të cilat pa kontakte dhe përmirësim me qeverinë nuk mund të tejkalohen. Në takimin i cili ishte i pari i këtij lloji, ishin ftuar të gjithë kryetarët e komunave në Kosovë, me qëllim të ndërtimit të një agjende të përbashkët bashkëpunuese, për t'i çuar përpara projektet e rëndësishme që kanë relacion me nivelin qendror.

Ministri Ismaili: Po u vjen fundi pritjeve të gjata në QKUK

PRISHTINË, 10 PRILL (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se pritet të gjatë të qytetarëve dhe shërbimet në kushte jo të favorshme për ta, shumë shpejt pritet të marrin fund në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Ai ka thënë se qytetarët tanë për shumë vjet

kanë pritur nëpër bodrumet e QKUK-së dhe në kushte aspak të favorshme për të marrë shërbime cilësore. "Këto pritje të gjata, të mundimshme dhe aspak të shëndetshme, shumë shpejt do të marrin fund. Investimi që po e bëjmë në ambulancat e reja specialistike do të mundësojë që qytetarët t'i

marrin shërbimet e tyre në një objekt modern, në kohë dhe të pajisur me gjithë infrastrukturën e nevojshme mjekësore, përfshirë edhe laboratorët. Ata meritojnë kushte më të mira për trajtime dhe gjatë këtij mandati, ofrimi i këtyre kushteve do të jetë përkushtimi im", ka thënë ministri Ismaili.



AKKVK-ja, institucion që ofron ndihmë për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit

Profesori Mensut Ademi në tetor të vitit 2009, së bashku me disa bashkëpunëtorë, ka themeluar Asociacionin e Kriminologëve, Kriminalistëve dhe Viktimologëve të Kosovës (AKKVK) që aktualisht ka rreth 800 anëtarë. Këtë asociacion nga viti 2009 e deri më tani e drejton vetë Ademi, i cili ka treguar se synimi i AKKVK-së është të arrijë deri te politikat strategjike nacionale dhe ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, si dhe të ofrojë programe për parandalimin e dukurive kriminale si delikuenca e të miturve, frika nga kriminaliteti, terrorizmi, radikalizmi, konfliktet në familje dhe rehabilitimi i personave gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas vuajtjes së dënimit. Ademi ka bërë me dije për "Epokën e re" se AKKVK-ja ka bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 10 PRILL - Në tetor të vitit 2009 në Prishtinë është themeluar Asociacioni i Kriminologëve, Kriminalistëve dhe Viktimologëve të Kosovës (AKKVK), i cili drejtohet nga Mensut Ademi dhe anëtarë të tjerë themelues të këtij asociacioni. Ademi ka përfunduar fakultetin dhe magistraturën në fushën e kriminalistikës, kriminologjisë, studimeve të sigurisë në Universitetin e Sarajevës dhe ka filluar shkallën e tretë të doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore SEEU në Maqedoni dhe ka përfunduar studimet e doktoraturës për shkenca penale. Ai vazhdon shkallën e tretë në fushën e kriminologjisë. "Nëse shihni, edukimi im bazik dhe ai i shkallës së dytë magjistër janë në fushën e kriminologjisë, kriminalistikës dhe studimeve të sigurisë, ndërkohë kam identifikuar problemin e kualifikimeve të profileve në Republikën e Kosovës së kriminologjisë, kriminalistëve dhe viktimologëve, të cilëve nuk u jepet shumë rëndësi apo kemi shumë pak njohuri. Për shembull, në konkurset për punë nuk shihet se kërkohet kriminalist i diplomuar, kriminolog i diplomuar, viktimolog i diplomuar. Kjo ka qenë edhe shtytja ime dhe e shumë kolegëve të mi për fillimin e një shoqate e cila do t'i promovonte dhe ndihmonte të gjithë ata të cilët kanë studiuar në fushat e lartcekura", ka thënë Ademi në këtë intervistë për gazetën "Epoka e re". Ai ka theksuar se duke u nisur nga fakti se në Kosovë kemi profesorë të njohur në region dhe atë ndërkombëtar siç është prof. dr. Ragip Halili si një nga kriminologët, viktimologët, penologët më të njohur në Ballkan dhe Evropën Perëndimore, prof. dr. Vesel Latifi si kriminalisti i njohur në region, atëherë Ademi thotë se

ka marrë guximin që përmes literaturës bashkëkohore dhe të autorëve të lartcekur, të vijë deri te qëllimi për ta krijuar Asociacionin e Kriminologëve, Kriminalistëve dhe Viktimologëve të Kosovës (AKKVK). Sipas tij, synimi i AKKVK-së është të arrijë deri te politikat strategjike nacionale dhe ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në përgjithësi, t'i edukojë institucionet adekuate se si të vendosin standardet ndërkombëtare bashkëkohore



për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe joqeveritare si ato nacionale dhe ndërkombëtare, të vijë deri tek identifikimi i masave sa më adekuate për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, përgatitjen dhe implementimin e programeve dhe studimeve sa më bashkëkohore që mundëson parajmërimin e hershëm për ndonjë dukuri kriminale si delikuenca e të miturve, frika nga kriminaliteti, terrorizmi, radikalizmi, konfliktet në familje, rehabilitimi i personave gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas vuajtjes së dënimit etj. "Duke siguruar kontributet shkencore dhe profesionale për krijimin dhe zbatimin e politikave për të parandaluar dhe luftuar kundër krimit, AKKVK-ja si Qendra për Kërkime mbi politikën e parandalimit të krimit realizon qëllimet e veta



përmes hulumtimeve shkencore si projekte profesionale dhe shkencore, organizimin e konferencave shkencore me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të Qendrës në konferenca shkencore dhe botimin e punimeve shkencore, promovimeve dhe avokimeve si masa për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar", ka thënë Ademi.

Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare

Drejtori i Asociacionit të Kriminologëve, Kriminalistëve dhe Viktimologëve të Kosovës, Mensut Ademi, ka bërë me dije se kanë filluar bashkëpunimin me



institucione nacionale dhe ndërkombëtare, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, si dhe me Komunitetin e Fushë-Kosovës, të Ferizajt, të Gjakovës, të Vushtrrisë, të Prishtinës, të Kaçanikut, të Vitisë

dhe me komunat e tjera. Po ashtu, ai ka treguar se kanë bashkëpunim edhe me disa institucione edukuese, si Kolegjin AAB, i cili ndihmon në të gjitha format për ta arritur qëllimin e AKKVK-së, Universitetin e Curihut - Institutin e Kriminologjisë, St Gallen University Swis, Charles University Pragë, Kolegjin Juridika, KCSE FIQ, USAID, IAAB, WBC etj. "Ne kemi arritur të jemi edhe anëtarë në disa organizata ndërkombëtare si ESC European Society off Criminology, Instituti i Studimeve të Sigurisë, Kriminalistikës dhe Sigurisë BiH, BC Balkan Criminology dhe ASC American Society off Criminology. Për herë të parë si Republikë e Kosovës jemi anëtarë me të drejtë kandidimi dhe votimi për strukturat e lartshënuara", është shprehur Ademi.

Ai ka treguar se si asociacion kanë hasur në probleme të ndryshme. "Kemi hasur në shumë probleme të implementimit të qëllimit përmes strategjisë së AKKVK-së, por ajo që vlen të përmendet është se me vullnetin tonë dhe shumë vullnetarëve të këtyre fushave kemi filluar një rrugëtim për ta arritur qëllimin për të mirën e banorëve të Republikës së Kosovës dhe vendeve në region. Ne kemi zgjedhur metodat dhe studimet adekuate shkencore të njohura ndërkombëtarisht për të ardhur deri te parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit dhe kemi një staf dhe bashkëpunëtorë shumë profesionalë. Pra, si asociacion kemi arritur të kemi njërin e duhur në kohën e duhur dhe në vendin e duhur", ka pohuar Ademi.

Ai ka folur edhe për vështirësitë që u shfaqën në punën e tyre. "Problematika e cila na shfaqet më së shpeshti është 'plagjiatura' apo qasja e shumë grupeve apo individëve ndaj problematikave jo në mënyrën, formën më profesionale duke përdorur metoda dhe statistika sa më bashkëkohore shkencore. Dua ta potencoj një thënie të një profesori nga Kroacia, i cili në ligjëratat na shpjegonte se duhet të kemi kujdes sepse ka tri lloje gënjeshtresh: e mirë, e keqe dhe statistika. Kjo e fundit, statistika, nuk është gënjeshtër, por mostra e cila është marrë për analizë është gabimisht", ka theksuar drejtori i AKKVK-së, Mensut Ademi.

Problem si çdo vend ka edhe Kosova me delikuençën e të miturve, që paraqet kërcënim për rininë. I pyetur se si qëndron Kosova në këtë aspekt në krahasim me shtetet e rajonit, Ademi ka paralajmëruar se së shpejti si AKKVK do t'i publikojnë të dhënat për këtë çështje. "Për herë të parë në vitin 2009-2010, së bashku me Universitetin e Sarajevës, Fakultetin FKKN dhe Kolegjin AAB, kemi implementuar ISRD2. Për këtë hulumtim shkencor ndërkombëtar na ka ndihmuar Fakulteti Juridik dhe Kriminalistik në Kolegjin AAB, kurse pyetësin e standardizuar sipas ESC dhe ASC na kanë ofruar prof. dr. Muahamed Budimlic, prof. dr. Mudazat Korajlic, prof. dr. Elmedin Muratbegovic, ku ne për herë të parë kemi qasje adekuate në studimet shkencore të pranuarat ndërkombëtarisht dhe metodat bashkëkohore shkencore. ISRD 2 International Self-Report Delinquency Study, 2009-10. ISRD 3 International Self-Report Delinquency Study, 2014-17. Përmes këtyre studimeve kemi ardhur deri te disa të dhëna adekuate se cilat janë shkaqet dhe format e sjelljeve asocial, devijante nga personat e mitur në Republikën e Kosovës dhe në region. Këto ditë së shpejti do t'i publikojmë të dhënat e fituara në Republikën e Kosovës, Kroacisë, Sllovenisë, Serbisë, Bosnje Hercegovinës, Maqedonisë, Ukrainës dhe Zvicrës", ka thënë ai. Ademi ka folur edhe për të ardhmen e Asociacionit të Kriminologëve, Kriminalistëve dhe Viktimologëve të Kosovës. "Asociacioni ka deri më tani rreth 800 anëtarë. Ne do ta rrisim anëtarësinë, do ta fillojmë bashkëpunimin me institucione të Republikës së Kosovës në forma inovative dhe do të kërkojmë nga ekzekutivi dhe legjislativi të na ndihmojnë të jemi një nga institucionet e pavarura për interesa nacionale, duke u nisur nga paralajmërimi i hershëm deri tek ekzekutimi i sanksioneve penale", ka bërë me dije drejtori i AKKVK-së, Mensut Ademi.



ASK-ja: Çmimet e konsumit shënuan rritje

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0.1 për qind në muajin mars 2018 krahasuar me muajin shkurt po të këtij viti

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 PRILL - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin mars të vitit 2018. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit prej muajit janar 2016 publikohet me vitin bazë 2015=100. Sipas ASK-së, indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0.1 për qind në muajin mars 2018 krahasuar me muajin shkurt po të këtij viti. "Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e lehtë të çmimeve të konsumit të disa nëngrupeve të COICOP-it: pemë (1.4 për qind), përdorim i pajisjeve për transportin personal (0.3 për qind), shërbimet për transport (2.2 për qind) - (ngritje e çmimit të biletave me aeroplan), gjëra personale (0.5 për

qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.2 përqindësh në IHÇK", thuhet në njoftimin e ASK-së. Sipas këtij njoftimi të ASK-së, ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e lehtë e disa çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it, me një ndikim të përbashkët prej (-0.1 përqindësh) në IHÇK. "Shkalla e inflacionit e matur në muajin mars 2018 me muajin mars 2017 ishte 0.1 për qind. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0.1 për qind në muajin mars 2018 krahasuar me muajin mars 2017. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (1.9 për qind), mish (1.2 për qind), pemë (8.8 për qind), kafe dhe çaj (3.9 për qind), duhan (3.2 për qind), përdorim i pajisjeve për transportin personal (0.8 për



qind), shërbime për transport (7.1 për qind) - (ngritje e çmimit të biletave me aeroplan) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.8 përqindësh në IHÇK", është bërë me dije në njoftimin e ASK-së. Sipas ASK-së, ngritja u neutral-

izua kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: sheqer dhe ëmbëlsira (-8.5 për qind), rrymë, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (-8.7 për qind) - (rënie e çmimit të energjisë elektrike në muajin mars 2018 për (-15.4 për qind),

krahasuar me tarifat dimërore të muajt mars të vitit 2017), pajisjet audiovizuale, fotografike për përpunimin e informatave (-6.3 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.7 për qindësh) në IHÇK.



Lekaj kërkon jetësimin e lidhjes hekurudhore Kosovë - Mali i Zi

PRISHTINË, 10 PRILL (ER) - Ministri i Infrastruktursë, Pal Lekaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Kosovës në Mal të Zi, Skënder Durmishi, me të cilin ka biseduar për iniciimin e marrëveshjeve bashkëpunuese për projekte infrastrukturore, të cilat do të shërbenin për rritjen, forcimin dhe për zhvillimin ekonomik të të dyja vendeve. Duke i vënë një theks të veçantë lidhjes hekurudhore Kosovë - Mal i Zi, lidhje kjo e cila për momentin

nuk ekziston, ministri Pal Lekaj ka shfaqur interesim, duke pohuar se Ministria e Infrastruktursë është e interesuar që kjo ide të bëhet jetike. Ai ka thënë se me ndërtimin e lidhjes hekurudhore do të zhvillohej edhe turizmi, ku qytetarëve do t'u ofrohej edhe më shumë mundësi se tani, të merren me sport dhe rekreacion. "Meqenëse ky takim ishte vetëm plasim i ideve dhe shikim i mundësive për projekte hekurudhore, të cilat në një

të ardhme mund të implementohen, ministri Lekaj deklaroi se nënshkrimi i marrëveshjeve bashkëpunuese do të shërbente si një lloj shtytjeje për fillimin e këtyre proceseve", ka thënë Lekaj. Kurse ambasadori Skënder Durmishi ka thënë se linjat hekurudhore do të ndikojnë për forcimin e lidhjes fqinjësore dhe asaj ekonomike në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, duke e lehtësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve, sidomos tregtinë.

Beqaj: Mendimi ekonomik në vendin tonë duhet të ndryshojë

PRISHTINË, 10 PRILL (ER) - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka marrë pjesë të martën në lansimin e programit "Elevator Lab Challenge" iniciuar nga "Banka Raiffeisen". Në hapje të këtij aktiviteti, në cilësinë e panalistit, ministri Besim Beqaj ka folur për rëndësinë e ndryshimit të qasjes në zhvillimin ekonomik të Kosovës, përmes digitalizimit dhe përdorimit të inovacionit. "Inovacioni është e ardhmja, por që realisht është edhe një sfidë të cilën duhet ta adresojmë të gjithë", ka thënë Beqaj. Ai ka folur edhe për aktivitetet e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në lidhje me hartimin e kornizës ligjore dhe strategjike si bazë e mirë për

përkrahje të inovacionit në shërbim të zhvillimit ekonomik. Beqaj ka paralajmëruar se sot (e mërkurë) në mbledhjen e radhës të Këshillit Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi do të prezantojë një sërë dokumentesh ligjore dhe strategjike, si dhe politikën për ndarjen e subvencioneve dhe granteve në fushën e përkrahjes së inovacionit dhe ndërmarrësisë. Programi "Elevator Lab Challenge" do ta hapë fazën e aplikimit më 23 prill. Ky aplikim do të jetë i hapur për të gjitha ndërmarrjet nga Kosova të cilat kanë ide inovative në fushat e analizave të avancuara, shërbimeve bankare për biznes, teknologji të investimit dhe tregtisë.



Paralajmërohet hapja e një banke për diasporën në Kosovë

Përfaqësuesit e Rrjetit të Bizneseve të Diasporës nga ShBA-ja, gjatë takimit me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, kanë shprehur gatishmërinë për fillimin e procedurave për hapjen e bankës së diasporës në Kosovë

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 PRILL - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e Rrjetit të Bizneseve të Diasporës Shqiptare me seli në ShBA, të kryesuar nga presidenti Nazar Mehmeti, sekretari i përgjithshëm Ismet Smajlisi dhe drejtori Naim Dedushaj. Guvernatori Mehmeti ka falënderuar delegacionin e Rrjetit të Bizneseve të Diasporës Shqiptare në ShBA për interesimin e tyre në sistemin financiar në Kosovë dhe i ka informuar ata lidhur me zhvillimet e fundit në sektorin

financiar në Republikën e Kosovës dhe me treguesit e shëndetit financiar.

Gjithashtu, guvernatori Mehmeti ka theksuar kontributin e madh që diaspora shqiptare ka dhënë në të kaluarën dhe po vazhdon ta japë për zhvillimin ekonomik të Kosovës, përfshirë këtu nevojën e madhe që të hyrat nga diaspora të transformohen nga konsumi në investime që do të kontribuonin në zhvillim ekonomik të Kosovës. Në këtë takim është diskutuar mundësia e investimit në sektorin bankar të Republikës së Kosovës, ku përfaqësuesit e Rrjetit të Bizneseve të Diasporës nga ShBA-ja kanë shprehur gatishmërinë për fillimin e proce-



durave për hapjen e bankës së diasporës në Kosovë. Guvernatori Mehmeti ka

mirëpritur një iniciativë të tillë dhe ka informuar përfaqësuesit e Rrjetit të Bizneseve të Diasporës

Shqiptare lidhur me kërkesat ligjore të BQK-së për licencimin e një banke.

Unioni i Bizneseve Shqiptare-Gjermane shpreh interesim për investime në Kosovë dhe Shqipëri



PRISHTINË, 10 PRILL (ER) - Në një takim të organizuar nën përkujdesjen e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Zurich, ministrat e dy shteteve shqiptare për Diasporën, Pandeli Majko dhe Dardan Gashi, kanë takuar komunitetin e bizneseve shqiptare në Zvicër. Duke

çmuar lart kontributin e deritanishëm të mërgatës, të dy ministrat kanë bërë thirrje që afaristët shqiptarë nga mërgata të bëhen pjesë e pjesëmarrjes në projektet strategjike. Përfaqësuesit e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane,

nënkryetari Zenun Krasniqi dhe drejtori ekzekutiv Bekim Brestovci, kanë njoftuar ministrat Majko dhe Gashi, se Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, krahas investimeve të deritanishme të bëra nga anëtarët e Unionit në shtetet e origjinës, tani janë në fazën e dytë të

përgatitjes së dokumentacionit për aplikim për marrjen e licencës për hapjen e Bankës Zhvillimore të Diasporës në Kosovë. Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane ka shprehur gatishmërinë të jetë në kontakt me kontribuues në të gjitha projektet të

cilat nga qeveritë e të dyja shteteve do të shihen si projekte të një rëndësie strategjike. Në fund të takimit u shpreh edhe një vullnet i madh që të hapen zyrat e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Tiranë dhe në Prishtinë.

Përveç deklaratës universale të KB-së për të Drejtat e Njeriut dhe Konventave Evropiane, Kosovës nuk i duhet asgjë tjetër



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Diskriminimi pozitiv, formulim idiotesk dhe kundër të drejtave të njeriut: Kosova në vitin 1999 doli nga lufta thuaja 100-vjeçare kundër dhunës dhe tiranisë sllave; së pari këtë dhunë e ushtroi Mbretëria Serbo-Kroate-Sllavene për ta vazhduar Jugosllavia nacional-socialiste, pas Luftës së Dytë Botërore, me kriminelët Tito, Ranković, Mugosha, Tempo, Ali Shukria, Nimanët dhe Hoxhët, Sinan Hasani dhe Shefqet Peqi i Shqipërisë që bënë masakra në Drenicë dhe Tivar sikur që eliminuan çdo atdhetar që e kundërshtonte mbetjen nën Jugosllavi. Pastaj këto krime vazhduan, pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë nga federata e Zhablakut (Serbia dhe Mali i Zi) për të përfunduar me krim gjenocidal (të pandëshkuar) nga Serbia e Millosheviqit, Sheshelit, Arkanit, Vuçiqit, Daçiqit dhe kriminelëve të tjerë të shndërruar tani në paqësorë. Kriminelë paqësorë! Serbia në Kosovë vrau dhe masakroi 12 000 shqiptarë, dhunoi një numër të madh të femrave shqiptare si mjet lufte, dhunshëm depërtoi mbi 800 000 shqiptarë, shkatërroi mbi 120 000 objekte banesore, shtëpi, shkolla, objekte biznesi, xhami dhe objekte të tjera fetare si edhe ato të trashëgimisë kulturore. Vodhi çdo gjë që mund të merrte me vete sikur që vodhi edhe kursimet bankare të qytetarëve të Kosovës dhe të Fondit Pensional. Serbia, pas përfundimit të luftës së lavdishme të UÇK-së, jo që nuk e kompensoi asnjë dëm material

dhe jomaterial që e bëri në Kosovë, por si "trashëgimi" ia la qindra-miliona euro borxhe të përbashkëta Kosovës e cila, me gjithë varfërinë që e ka, po detyrohet t'i shlyejë ato borxhe ndonëse është përjashtuar nga çdo e drejtë e ndarjes së pronës së përbashkët të ish-Jugosllavisë. Serbia njihet si vendi i vetëm në botë që të ekzekutuarit në Kosovë apo pengjet e luftës të dërguar në Serbi, në përpjekje për t'i fshehur krimet e bëra, ato që nuk arriti t'ia zhdukë mbetjet mortore, i varrosi në një lokacion ushtarak, në Batajnicë dhe për këtë nuk pati fare konsekuencë. Çka bënë me organet e të ekzekutuarve, vetëm Serbia e di, ndërkohë që ua futi shqiptarëve, përmes një mercenari me imunitet, trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafikim të organeve njerëzore. Shqiptarët nuk e deshën luftën, por e morën si të vetmin mjet dhe mundësi të çlirohen nga një regjim kriminal dhe robëri, më shumë se 100-vjeçare. Ishte çmimi që duhej paguar dhe e paguan. Shqiptarët nuk luftuan për ta mbrojtur prapenjë dhe familjen, por luftuan për një qëllim shumë më të lartë, çlirim nga Serbia dhe përcaktimin se me kënd duan të bashkohen apo të jetojnë! Kërkuan që ky vullnet të përcaktohet me referendum, si mjeti më demokratik që zbatohet në të gjitha vendet e botës demokratike. Shqiptarëve iu mohua padrejtësisht kjo e drejtë për disa arsye: a) ndërkombëtarët nuk donin që Kosova të bëhej shtet; b) kursehej dhe shpërblehej një vend kriminal sikur që është Serbia; dhe, c) negociatorët shqiptarë ishin kryesisht karrieristë, lakmitarë, injorantë, të pavendosur e që disa prej tyre u shndërruan në kriminelë të rrezikshëm dhe plaçkitës të pamëshirshëm të pronës publike dhe private!

Organizimi mafioz në Kosovë filloi menjëherë pas përfundimit të luftës dhe çdo viktimë serbe (kryesisht pleq dhe plaka) është bërë jo se kanë qenë patriotë, por se kanë qenë horra dhe plaçkitës, duke ua marrë dhunshëm pronat e serbëve. Kjo është e vërteta e pasluftës në Kosovë dhe për këtë kanë qenë të informuar ndërkombëtarët sikur që edhe shumë krime janë bërë në prani të tyre. Prandaj as ndërkombëtarët nuk mund dhe nuk duhet të përjashtohen nga përgjegjësia. Arrestimi dhe gjykim i shqiptarëve për këto krime është vullsur me Marrëveshjen e Kumanovës ku shqiptarët janë përjashtuar nga vendimmarrja për fatin e Kosovës dhe qytetarëve të saj, ndërkohë që kanë marrë detyrime ta ç'armatosin UÇK-në nga pushkallat muzeale sikur që kanë lejuar që BIA serbe të operojë lirshëm në Kosovë si dhe të stabilizohet regjimi kriminal i Serbisë në Kosovë. Po të donin që Kosova të formohej dhe zhvillohej si çdo vend normal në botë, qershori i vitit 1999 ka qenë koha më e mirë për ta bërë këtë. Regjimi kriminal i Serbisë ishte i nokautuar, Kosova ishte krejtësisht e shkatërruar me shumë të vrarë të mbetur rrugicave, në fusha apo në male dhe në vende të tjera. Realisht, Serbia do të duhej të përjashtohet, nga çdo prani në një periudhë 30-vjeçare nga Kosova (ashtu janë dënuar humbësit pas Luftës së Dytë Botërore) dhe në këtë mënyrë serbët e mbetur do të integroheshin shumë më lehtë, është dashur që të merret një pjesë e Serbisë (Kurshumlia apo Prokupja e të negociojë Serbia për kthim të atyre tokave e jo tokave të Kosovës), strukturat kriminale shqiptare nuk do të

konsolidoheshin duke e vënë regjimin e terrorit, duke vrarë pleq dhe plaka serbe për t'i plaçkitur ato sikur edhe do të kurseheshin shqiptarët nga këto banda kriminale që skajshmërisht e keqpërdorën luftën e shenjtë të UÇK-së, mbase një pjesë e madhe e tyre as që ka qenë pjesë e luftës. Bëhej luftë për pushtet midis krahut të luftës dhe refugjatit të Shën Exhidios, Ibrahim Rugovës dhe, për shkak të sjelljeve shumë të këqija e që identifikoheshin me luftën, Himë Gova, në zgjedhjet e para dhe të tjera i bëri përshesh injorantët që mendonin vetëm për pushtet, në kohën që nuk kishin shtet. Ishin patetike dhe folklorike sloganet si: "Kosovë, haram të qoftë gjaku i derdhur..." sepse u derdh edhe gjaku që nuk duhej të derdhej, civilëve të pafajshëm dhe disa kundërshtarëve politikë! Moskonsolidimin e Kosovës si shtet e ndihmuar ndërkombëtarët me Serbinë, por goditjen vendimtare ia dhanë vetë shqiptarët. Anarki e organizuar e banditëve të pasluftës: Ata që luftuan për liri të vendit dhe shtet, mbetën në margjina duke mos u përljer me punë të pista. Jemi dëshmitarë që pas përfundimit të luftës për një banesë të serbëve, për një lokal, "pa pronarë" janë vrarë shqiptarët mes vete, sikur të ishte pronë që ua ka lënë baba dhe babagjyshi. Jemi dëshmitarë se disa familje që kishin edhe brekët e grisura, pas përfundimit të luftës u bënë milionerë duke gllabëruar çdo hapësirë dhe aset publik, duke krijuar monopol të jashtëzakonshëm gjatë ndarjes së tenderëve miliona euro, gjatë privatizimit kriminal ku më së shumti përfitoi "vëllazëria shqiptaro-turke" si dhe Pizza Connection nga Amerika. Në planin e paluajshmërive biznesi kryesor bëhej midis "të fortëve" të Kosovës dhe mafies së Serbisë, me ndërmjetësimin e avokatëve

të kriminalizuar! Pas përfundimit të luftës, varësisht lokacionit, nuk keni mundur të blini pronë apo lokal nga serbët pa paguar prej 20 000 e deri në 300 000 marka të konvertuara në euro. U bë gjenocidi në shkurt të vitit 2000 në veri të Mitrovicës ndaj shqiptarëve dhe joserbëve sikur edhe në mars të vitit 2004 ndaj serbëve. U dërguan në Hagë Haradinaj dhe Limaj për t'u liruar krejtësisht të pafajshëm. Pas ngjarjeve të marsit 2004 filluan presionet ndaj shqiptarëve, për të pranuar një status të veçantë për serbët duke e shpikur një term idiotesk e që nuk parashihet me asnjë dokument për të drejtat e njeriut; diskriminimi pozitiv për serbët. Vet diskriminimi, si shprehje nënkupton diçka negative dhe assesi pozitive. Me këtë shprehje idioteske që e pranuan juristët llaskuç shqiptarë nga përvoja e tyre e gjatë të shërbimit ndaj kriminelëve Tito dhe Millosheviq e fuqizoi Serbinë në Kosovë sikur që ndihmoi në përligje të një masakre juridike siç ishte Pakoja e Ahtisarit. E keni parë si, ish-shërbëtorët e kriminelit Tito dhe injorantët shpirtkëqij të dalë nga lufta e të magjepsur pas pushtetit, dritës së kamerave, udhëtimeve ekzotike dhe takimeve me burokratë ndërkombëtarë, me sa pasion dhe ereksion e përmendnin emrin e presidentit Ahtisari, kriminelit kushtetues që e bëri një Kushtetutë të varur nga serbët dhe Serbia. Tash, pasi u ka hyrë deri në rrënjë, flasin për domosdoshmërinë e ndryshimeve të Kushtetutës ndonëse e kanë të qartë se pa 2/3 e votave të pakicave, nuk mund të ketë asnjë ndryshim kurse serbët kurrë, në këto rrethana nuk do të pranojnë të bëhen këto ndryshime. Hajdutët, idiotët dhe llaskuçët kurrë nuk e kanë dashur vendin e tyre dhe as që e duan. Marrëveshja e Vjenës ishte hyrje

Vihet gurthemeli i objektit të QMF-së në fshatin Milloshehevë

OBILIQ, 10 PRILL (ER) - Të martën në fshatin Milloshehevë të Komunës së Obiliqit është vënë gurthemeli i objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF). Kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka thënë se ndërtimi i këtij objekti të QMF-së në këtë fshat është mjaft i nevojshëm për punonjësit, banorët dhe për fshatrat përreth. "Ndërtimi i këtij objekti tregon edhe një herë përkushtimin e

qeverisjes aktuale për t'i shtrirë investimet në të gjithë sektorët në komunën tonë. Funksionalizimi i hapësirave të reja, po ashtu plotësimi me staf profesional si dhe investimi në aparatura dhe materiale të tjera shëndetësore, dëshmon për ndryshimin drastik të gjendjes në sistemin shëndetësor", ka thënë Gashi, duke shtuar se investimi në këtë objekt do ta

lehtësojë punën e stafit shëndetësor në drejtim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore sa më cilësore.

Ndërkaq drejtori i Shëndetësisë, Ibush Mjekiçi, ka thënë se ndërtimi i kësaj hapësire do ta lehtësojë punën e stafit shëndetësor, po ashtu do ta rrisë edhe efikasitetin në shërbime.

Ndërtimi i QMF-së në fshatin Milloshehevë është donacion nga Kuvajti.



dhe përfundim i një Kosove jofunkionale dhe lavdërimet që e sollën pavarësinë negociatorët (që fituan në emër të honorarëve 200-300.000 euro), përmes dhënies së drejtës së vendimit përcaktues Pakos së Ahtisarit, mbi Kushtetutën e Kosovës! Kësi rasti nuk mund të gjeni në asnjë vend të botës. Bisedimet për normalizim të marrëdhënieve ...me Leshistanin: Me forcimin e rolit të Serbisë në Kosovë, ndërkom-bëtarët e rritën presionin mbi shqiptarët të nisin bisedimet me Serbinë, duke krijuar situatë sikur kur shkon: "cjapi, te kasapi".

Dy persona më negativ që e dëmtuan më së shumti Kosovën gjatë këtyre bisedimeve ishin Edita Tahiri për të cilën, personi i dytë shumëfish më negativ se Edita dhe jashtëzakonisht i dëmshëm për Kosovën e shpiku një post, ministër për bisedime teknike ishte dhe është presidenti i terminalëve dhe ambasadorëve (çmimi për votë), Hashim Thaçi. Këta të dy arritën që "përmes bisedimeve teknike", ta shndërrojnë Serbinë në një partner kryesorë për punë të brendshme të Kosovës. Jam i sigurt se këtë nuk do ta bënte as Serbia, po të kishim përfaqësues më të ditur dhe më të denjë. Do ta dëmtojnë edhe më shumë, deri në zhbërje të shtetit përmes ndarjes, duket të pashmangshme të një pjese të Kosovës përmes një projekti puro kundër Kosovës siç është Asociacioni i Komunave të Serbisë në Kosovë. Nuk ka gjasa që ky Asociacion të formohet sipas Kushtetutës së Kosovës por do të bëhet sipas Marrëveshjes së Brukselit. Kjo përbajtje e një Asociacioni eksteritorial mund të mbështillet me brekët apo brekushet e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese që nuk kanë kurajo ta kundërshtojnë një vendim të politikës. Ku keni parë në botë që e një vendi, në rastin konkret Kushtetuta e Kosovës shkelet në plotë 24 raste dhe askush nuk i nënshtrohet përgjegjësisë!? Duhet të jeni idiot, par excellance, të thuani se Kushtetuta është shkelur 24 herë por mund të vazhdohet me formimin e Asociacionit.

Tash edhe ndërkom-bëtarët po e përkrahin idenë se nuk mund që dikush të fitojë të gjitha kurse dikush i humb të gjitha! Kjo nënkupton se janë për ndarje të Kosovës vetëm se duhet kohë që opinioni të mësohet dhe të pajtohet. Hashim Thaçi, si politikan i improvizimeve të çastit, tash po bien në nivelin e rrugaçëve siç janë Marko Gjuriq dhe Aleksandar Vulin, duke kër-cënuar se serbët do të priten me pushkë. Hashimo, me çka po i mbushë ato pushkë, me pordhë aa? Dhe kush të vjen pas në këtë

luftë virtuale?! Askush dhe asnjëri sepse të gjithë shokët i ke larguar dhe nuk duan t'i shohin as sytë! A ka më keq se dikush që ka bërë luftë të drejtë dhe për liri të bien nën provokim të kriminelëve sikur Daciq, Vuçiq, Vulin dhe Marko Gjuriq. Gjuriq dhe Vulin janë vetëm pionë në lojën e shahut politik midis Vuçiqit që aktualisht është mbret, Hashim Thaçit që është mbretëreshë kurse Vulin dhe Gjuriq, nga pionët, më së shumti mund të bëhen ashtu si edhe janë; kuaj të Banatit. Këta, nga pioni nuk mund të bëhen as top, as mbretëreshë e as oficerë, por vetëm kuaj. E vetmja mundësi që u mohohet pionëve edhe me rregullat e shahut është se nuk mund të bëhen mbret.

Çmendurisht e votuan Gjykatën Raciste Speciale që ndanë padrejtësi në baza etnike sikur që bënë përpjekje edhe më çmendurisht, ta shfuqizojnë këtë Gjykatë e që nuk patën koqe, as për veprimin e parë e as për të dytin! Çmendurisht kidnapuan gjashtë shtetas turq dhe ia dorëzuan në pjatë Erdoganit, sikur dikur kokën e Ali Pashë Tepelenës. Edhe nëse këta turq do të ishin kriminelët më të mëdhenj në botë dhe t'i kishim dëshmuar krimet më të rënda të tyre, si shtet ligjor, është dashur të përfillen të gjitha procedurat ligjore dhe pastaj, nëse do të shtereshin të gjitha mundësitë ligjore, do t'i lihej në dorë ministrit të Drejtësisë që, me një vendim politik ta nënshkruaj ekstradimin e tyre. Nuk janë maja e përgjegjësisë Flamur Sefaj dhe Driton Gashi. Ata janë vetëm zbatues të një urdhri politik që iu ka premtuar se: "pas deportimit krejtësisht kundërligjorë, nuk do të dënohen por se do të dërgohen në një vend ku do të takojnë 40 bukuroshe virgjëresha duke mos e ditur faktin se urdhëruesi i tyre moti ua ka marrë virgjërinë atyre bukurosheve dhe ua ka ngulur paq, edhe Flamurit, si dhe Dritonit...". Amerika nuk po e ekstradon Gylenin, prandaj nuk është vend demokratik dhe Kosova nuk mund ta durojë këtë jodemokraci, prandaj u bashkua me demokracinë e Gabonit. Ata i dorëzuan vetëm tre gylenistë, kurse Kosova i dorëzoi gjashtë gylenistë, që do të thotë se Gaboni e ka vetëm 50 % të demokracisë kosovare. Rroftë miqësia e re, e përjetshme dhe e pavdekshme midis dy shteteve më demokratike në botë: Kosovës dhe Gabonit! Çka janë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara dhe Konventat Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Pakicave Kombëtare përballë demokracive në Gabon dhe Kosovë! Kosova e ka një përparësi përballë Gabonit, diskriminimin idiotesk pozitiv!



Veseli: Doktor Hafir Shala ishte mjeku i plagëve të para të luftëtarëve të UÇK-së

DRENAS, 10 PRILL (ER) - Në 20-vjetorin e rrëmbimit nga forcat serbe të doktorit Hafir Shala, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, e ka cilësuar atë intelektual me diapazon të gjerë të dijes e të përgatitjes profesionale, humanist të jashtëzakonshëm dhe personalitet të shquar të Drenicës. Në një akademi të organizuar të martën për nder të doktor Hafir Shalës, Veseli ka thënë se ndonëse kanë kaluar dy dekada, shteti serb ende nuk ka dhënë llogari për fatin e tij. Kryeparlamentari Veseli ka thënë se doktor Hafiri ishte mjeku i plagëve të para të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe zhdukja e tij që në

ditët e para të luftës ishte pjesë e luftës speciale të Serbisë, nëpërmjet së cilës ajo synonte t'i frikësonte kolegët e doktor Hafirit që të qëndrojnë larg frontit të luftës. Por ky synim i errët, shtoi Veseli, nuk u realizua. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës e kishte nisur luftën për ta çliruar përfundimisht Kosovën. Radhët e saj brenda një kohe të shkurtër u dhjetëfishuan. Dhjetëra mjekë iu përgjigjen thirrjes së lirisë, duke ndjekur shembullin dhe guximin e doktor Hafirit. Sakrificat ishin të mëdha, por ne ia dolëm: Kosova fitoi lirinë dhe Serbia u dëbua përgjithmonë nga Kosova. Kosova sot është shtet i pavarur dhe

sovrani falë sakrificës mbinjerëzore të njerëzve tanë, në mesin e të cilëve ishte edhe doktor Hafir Shala", ka thënë Veseli. Ai ka shtuar se mirënjohja e thellë për mundin dhe gjakun e derdhur për liri do të ekzistojë përherë dhe se asnjëherë nuk do të pushohet së kërkuari drejtësi për krimet e kryera nga ushtria gjenocidale e Serbisë mbi popullatën shqiptare gjatë luftës. "Janë mijëra qytetarë tanë për fatin e të cilëve Serbia duhet të flasë, të tregojë të vërtetën për zhdukjen e tyre dhe të japë llogari. Në mesin e tyre edhe për doktor Hafir Shalën. E vërteta dhe drejtësia kurrë nuk vjetrohen", ka thënë kryeparlamentari Veseli.

Inkasimi i tatimit në pronë rritet për 40 për qind në Mitrovicë

MITROVICË, 10 PRILL (ER) - Nën kryesimin e nënkryetarit të Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur të martën mbledhjen e rregullt në të cilën janë diskutuar tema të ndryshme. Në këtë mbledhje drejtori për Financa, Shukri Gashi, ka njoftuar ekzekutivin lidhur me vendimin për fshirjen e borxheve në sistemin e taksave komunale për pjesën veriore, po ashtu drejtori Gashi ka kërkuar nga drejtorët t'i caktojnë prioritetet e pagesave për drejtoritë e tyre. Gashi ka njoftuar ekzekutivin se falë punës dhe bashkëpunimit të mirë inkasimi i tatimit në pronë është rritur për 40 për qind.

Ndërkaq drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Musa Dragaj, edhe në këtë mbledhje ka trajtuar çështjen e sanimit të dëmeve



tek varrezat e dëshmoreve. Me këtë rast, ekzekutivi u pajtua të ndiqen procedurat e rregullta të tenderimit që, për hir të famil-

jarëve dhe qytetarëve të komunës, sa më shpejt të sanohen dëmet tek varrezat e dëshmorëve.

Kina premton lëshime tregtare për Shtetet e Bashkuara

PEKIN, 10 PRILL - Presidenti kinez Xi Jinping premtoi të martën t'i ulë tarifën për makinat e importuara dhe ta përmirësojë mbrojtjen e pronësisë intelektuale, lëshime këto që synojnë t'i ulin tensionet në marrëdhëniet tregtare me Uashingtonin.

Duke folur në një konferencë biznesi, Xi nuk përmendi drejtpërdrejt homologun e tij amerikan, Donald Trump, ose mosmarrëveshjet tregtare. Ai premtoi përparim në fushat që janë përparësi për ShBA-në, duke përfshirë hapjen e industrisë bankare të Kinës dhe

shtimin e importeve. Megjithatë, ai nuk përmendi disa nga çështjet kryesore që e irritojnë Uashingtonin, siç është kërkesa e Kinës që kompanitë e huaja të investojnë aty përmes ndërmarrjeve të përbashkëta, të cilat u kërkojnë të huajve t'ua japin teknologjitë e

tyre firmave vendëse. Presidenti Trump ka kërcënuar t'i rrisë tarifën për mallrat kineze në masën 50 miliardë dollarë. Pekini u kundërpërgjigj me një listë të tijen të importeve amerikane, që kapin edhe ato një vlerë prej 50 miliardë dollarësh.



ShBA-ja dislokon Gardën Kombëtare në kufirin me Meksikën

Guvernatori i Arizonas, Doug Ducey, ka njoftuar se më shumë trupa do të dislokoreshin të martën dhe tha se mundet të përdoren trupa dhe teknologji në terren

UASHINGTON, 10 PRILL - Arizona po dërgon 225 trupa të Gardës Kombëtare në kufirin ShBA - Meksikë dhe guvernatori Doug Ducey tha se më shumë trupa do të dislokoreshin të martën. "Siguria kufitare është një shqetësim i madh këtu. Dy të tretat e kufirit tonë tashmë kanë një mur. Për mua do të ishte e mirëpritur ngritja e një muri për pjesën e mbetur të kufirit të shtetit tonë. Nuk më pëlqen mënyra se si kufiri ynë është i hapur dhe i pasigurt, veçanërisht në sektorin pranë distriktit të Tusonit. Gjithashtu, mendoj se ne mund të përdorim trupa dhe teknologji në terren", u tha Ducey gazetarëve të hënën. Arizona iu bashkua Teksasit, i cili dërgoi 250 trupa të Gardës Kombëtare në kufirin e tij jugor të premtën. Dy shtetet e tjera kufitare, Nju Meksiko dhe

Kalifornia, nuk kanë dislokuar asnjë ushtar të Gardës Kombëtare, edhe pse guvernatori i Nju Meksikos ka lënë të kuptohet se do ta bëjë këtë. Guvernatori i Kalifornisë nuk është shprehur mbi planet e shtetit të tij. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, nënshkroi një urdhër javën e shkuar duke autorizuar dislokimin e deri në 4 000 trupave të Gardës Kombëtare për ta siguruar kufirin. Urdhri siguron financimin e Pentagonit për trupat deri në shtator. Urdhri i Sekretarit Mattis specifikon se trupat e Gardës nuk mund të marrin pjesë në zbatimin e ligjit dhe mund të jenë të armatosur vetëm kur është e nevojshme për vetëmbrojtje. Një udhëzim i Departamentit të Mbrojtjes thotë se anëtarët e Gardës nuk do të angazhohen me emigrantët apo



persona të tjerë të ndaluar pa miratimin e sekretarit Mattis. Presidenti Donald Trump ka thënë se ai dëshiron që ushtria të mbetet në kufi derisa të ndërtohet një mur. Por në buxhetin e miratuar kohët e fundit, Kongresi miratoi fonde për vetëm një pjesë të kufizuar të murit të ri dhe disa

punime riparuese. Garda Kombëtare ka 435 000 ushtarë rezervë të cilët mund të aktivizohen nga Qeveria federale ose nga shtetet. Çdo shtet ka Gardën e vet Kombëtare, përfshirë Porto Rikon dhe Distriktin e Kolumbias. Guvernatorët shpesh dërgojnë Gardën për të ndihmuar

në raste fatkeqësish natyrore ose trazirash civile. Kushtetuta autorizon Qeverinë federale të përdorë Gardën Kombëtare për t'i "ekzekutuar ligjet e vendit, për t'i shtypur kryengritjet dhe për ta penguar pushtimin e vendit". Numri i njerëzve të kapur gjatë përpjekjes për ta kaluar kufirin ShBA-Meksikë u zvogëlua vitin e kaluar, por ka filluar të rritet në vitin 2018. Javën e kaluar, Patrulla amerikane e Doganës dhe Mbrojtjes së Kufirit njoftoi se më shumë se 50 000 njerëz u arrestuan duke u përpjekur ta kalonin kufirin në mars. Kjo shënon një rritje në krahasim me marsin e vitit të kaluar kur u kapën vetëm 16 500 njerëz. Megjithatë, numri i të ndaluarve në kufi në mars të viteve 2013 dhe 2014 ishte shumë më i lartë. Ndalimet në kufi janë shumë më të ulëta në krahasim me kohën kur ish-presidentët George W. Bush dhe Barack Obama dislokuan Gardën Kombëtare në kufi në vitet 2006 dhe 2010.

Trumpi anulon vizitën në Amerikën Jugore, shqyrton vendimin për Sirinë



UASHINGTON, 10 PRILL - Forcat qeveritare siriane janë vënë në gatishmëri të lartë në të gjithë vendin, nga frika e një goditjeje amerikane, pas një sulmi të kryer me sa duket me armë kimike pranë Damaskut. Siria ftoi të martën organizatën vëzhguese ndërkombëtare të armëve kimike për ta hetuar sulmin e dyshuar me gaz helmues gjatë fundjavës në një qytet të mbajtur nga

kryengritësit. Aktivistët e opozitës thonë se nga sulmi kimik janë vrarë 40 veta. Presidenti Donald Trump ka kërcënuar se do të ndërmarrë veprime ushtarake. Ai ka deklaruar se do të reagojë fort ndaj sulmit të së shtunës mbi civilët në qytetin Douma dhe ka paralajmëruar se Rusia ose çdo vend tjetër që mban përgjegjësi për sulmin do të paguajë një çmim.

Të martën presidenti Trump anuloi planet e një vizite në Amerikën e Jugut. Ai ka vendosur të qëndrojë në Shtetet e Bashkuara për ta menaxhuar kundërpërgjigjen amerikane ndaj ngjarjeve në Siri. Është hera e parë që një president amerikan nuk merr pjesë në Samitin e Kontinentit Amerikan. Në vend të tij do të shkojë nënpresidenti Mike Pence.


Hungaria do t'i shtrëngojë masat ndaj migrantëve

Budapest, 10 prill - Në Hungari partia në pushtet thotë se do të kërkojë t'i kufizojë aftësitë e organizatave civile për t'i ndihmuar emigrantët. Njoftimi vjen ndërkohë që kryeministri Viktor Orban fitoi bindshëm në zgjedhjet e së dielës duke bërë fushatë me një platformë kundër migracionit. Zyrtarët e partisë Fidesz në pushtet thonë se parlamenti do të

shqyrtojë në muajin maj ligje të reja që vënë në shënjestër shoqatat pro-emigrantëve dhe refugjatëve. Drejtoresha i një grupi hungarez për liritë civile, Stefania Kapronczay, pret një betejë të vështirë me Qeverinë. "Nuk pres që dy vjetët e ardhshëm të jenë të lehta. Besoj se Qeveria do të bëjë gjithçka që ka në dorë për ta

zvogëluar ndikimin tonë. Megjithatë, të drejtat e njeriut janë ide dhe nuk mund të bllokohen", tha ai. Partia Fidesz e Orbanit synon t'i detyrojë organizatat civile që ndihmojnë emigrantët që të licencohen nga Ministria e Brendshme për të funksionuar dhe do t'i taksojë me 25 për qind donacionet e huaja për grupe të tilla.





Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.

Nis "Java e Bibliotekës në Kosovë"

Haradinaj premtion për kujdesje për infrastrukturën e bibliotekave

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, me rastin e manifestimit "Java e Bibliotekës në Kosovë", u ka thënë drejtuesve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", se Qeveria do ta trajtojë me kujdes infrastrukturën e bibliotekave të Kosovës

PRISHTINË, 10 PRILL (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, kanë marrë pjesë të martën në manifestimin "Java e Bibliotekës në Kosovë", edicioni i XVI, me temën "Arsimimi dhe trajnimi bibliotekar". Kryeministri Haradinaj u tha drejtuesve të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", se Qeveria do ta trajtojë me kujdes infrastrukturën e bibliotekave të Kosovës. Para të pranishmëve të shumtë, kryeministri Haradinaj ka falënderuar dhe përgëzuar të gjithë ata që në ditë të vështira e mbijetuan librin, bibliotekën. Haradinaj ka përmendur vakuumin dhjetëvjeçar të paraluftës, shkatërrimet e luftës,

por edhe kohët emergjente, duke theksuar faktin se edhe në atë kohë nuk kemi qenë vetëm. "Më kujtohet, që herët, Ambasada e Amerikës, me një donacion të botimeve dedikuar qytetarëve dhe studentëve. E kam përcjell atë kohë dhe më pat bërë përshtypje", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke falënderuar Amerikën, popullin e saj, ambasadën, për këtë kujdes të vazhdueshëm. Më tutje, kryeministri Haradinaj ka pohuar se Qeveria jo mjaftueshëm kohë dhe vëmendje i kushton librit, bibliotekës dhe aktiviteteve që na bëjnë nder. "Duke ditur se kemi penda të çmuara që i çmon edhe bota, atëherë kishim mundur që në këto momente të tilla t'i shënojmë së bashku, t'i kemi edhe disa



prej penave më të çmuara shqiptare dhe duke i kujtuar edhe ata që s'janë me ne", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ndërsa ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vlerësuar këtë organizim tradicional, duke thënë se me sukses

ka trajtuar tema të ndryshme për ta sensibilizuar publikun për rëndësinë e bibliotekarisë dhe të librit në fushën e dijes dhe të kulturës. Ai ka thënë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e përkushtuar të ndihmojë funksionimin e mirë të bibliotekave në Kosovë. "Ky aktivitet që zhvillohet vijimisht tashmë e 16 vjet, ka arritur të zhvillojë e trajtojë tema dhe problematika të ndryshme nga fusha e bibliotekarisë, bibliografisë dhe fushës së informacionit, duke mbledhur edhe studiues, krijues, kritikë e hartues të politikave kulturore me qëllim të hedhjes dritë të arritjeve, sukseseve që kanë qenë evidente, por edhe të reflektimit mbi problematikat, sfidat dhe ngeçjet mbi këtë fushë, për t'i projektuar më mirë zgjidhjet dhe perspektivat e avancimit të kësaj fushe me rëndësi kritike për kulturën dhe dijen në Republikën e Kosovës", u shpreh ministri Gashi. Ministri veçoi se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e vetëdijshme për rolin e

bibliotekës dhe është angazhuar të krijojë kushte dhe bazë të mjaftueshme për zhvillimin normal të bibliotekarisë në Kosovë. Ai ka bërë me dije se MKRS-ja ka implementuar dhe ndërmarrë veprime konkrete duke sponsorizuar politika në favor të botimit, përkrahjes dhe shpërndarjes së librit përmes ndërtimit të kapaciteteve administrative e profesionale si dhe të ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm të mbështetjes financiare. Ministri, po ashtu, ka përmendur edhe sfidat me të cilat ballafaqohet bibliotekaria në Kosovë si dhe objekti i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Ministri Gashi ka falënderuar Qeverinë, institucionet dhe popullin amerikan për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë për bibliotekën, duke vënë në fokus miqësinë e përhershme dhe të gjithanshme në mes të Republikës së Kosovës dhe ShBA-së. Në kuadër të "Javës së Bibliotekës në Kosovë" është hapur edhe ekspozita me gravurat nga botimet e librave kushtuar Skënderbeut.



Limaj pret në takim artistët e mëdhenj të trevave shqiptare

PRISHTINË, 10 PRILL (ER) - Zëvendëskryeministri, njëherësh lider i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka pritur të martën në takim artistët e mëdhenj të trevave shqiptare, Arif Vladin, Nikollë Nikprelajn dhe Edmond Zhulalin. "Me kënaqësinë më të madhe prita në një takim artistë të mëdhenj të trevave shqiptare, Ilir Shaqirin. Shfrytëzoja rastin t'ua shpreh mirënjohjen time të thellë këtyre ikonave të

kultivimit dhe promovimit të vlerave kombëtare artistike shqiptare. Biseduam edhe për projekte artistike, me theks të veçantë rreth projektit për heroin kombëtar Gjergj Kastriotin Skënderbeun", ka thënë Limaj pas takimit. Ai ka shtuar se Qeveria e Kosovës po bën të gjitha përgatitjet e nevojshme që ta shënojë në mënyrën më të mirë të mundshme Vitin e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut.




Brooklyn Beckham puthet me një modele të "Playboy"-it



Brooklyn Beckham është fotografuar duke u puthur me modeluesen "e Playboy"-it, një muaj pasi ai është parë së fundmi me modeluesen 21-vjeçare Moretz duke nxitur kështu spekulime se ata janë ndarë. Në ndërkohë, kur

Beckhami së fundi është parë duke bërë një tatuazh, pranë tij ka qenë modeluesja nga Kanada, Lexi Wood. Bazuar në fotografite që tashmë kanë marrë dhenë, të dy kanë qenë të afërt duke biseduar dhe qeshur së bashku, duke ndarë edhe një puthje.

Hakerët fshijnë nga "Youtube" këngën "Despacito"



"Despacito" është kënga më e shikuar ndonjëherë në "Youtube", por kjo këngë është fshirë nga një haker kibernetik së bashku me dhjetëra video të tjera të shtëpisë diskografike "Vevo". Fshirja e videos

ka ardhur vetëm pesë ditë pasi u njoftua se kënga e Luis Fonsit dhe Daddy Yankee kishte arritur të thyente rekord, duke u bërë video më e parë në historinë e "Youtube"-s duke arritur pesë miliardë klikime.



Pasi fshiu fotografite, Zayn do ta heqë nga trupi edhe tatuazhin e Gigit

Këngëtari Zayn Malik po përpiqet të fillojë një kapitull të ri në jetën e tij pas ndarjes nga Gigi Hadid. Pasi fshiu të gjitha fotografite në rrjetin social "Instagram", përfshirë edhe ato me supermod-

eluesen, tani këngëtari po planifikon ta fshijë edhe tatuazhin dedikuar ish së dashurës. 25-vjeçari në gjoks ka bërë tatuazh sytë e Gigit dhe tash ka vendosur t'i heqë, në përpjekje për ta fshirë nga jeta.

Reperi i famshëm publikon këngën e re



Reperi kanadez Drake ka lansuar së fundmi këngën e re me titull "Nice for What". Bashkë me këngën, Drake ka lansuar edhe një video. Në regji të Karena Evans, klipi shfaqë portrete të yjeve të njohura si

Tiffany Haddis, Radhisa Jones, Issa Rae, Racee Ellis Ross, Yara Shahidi, Zoe Saldana e shumë të tjerë. Drake ka qëndruar në Toronto së fundmi për ta regjistruar albumin e pestë, që ai thotë se është "për qytetin nga vjen".

PËR TY, ENVER!



ISA FERIZAJ

Pranverat, përse vallë, ardhjen vonojnë?
Qan i nxiri qiell, të mallit lotë, i pikojnë!
As agimet pranverore, s'vijnë si atëherë;
Hutuar koha, n'mjegullnajë, paTy Enver!

Kokëvarurat gonxhelule, s'valëzojnë;
Qerpikëhalave pishat, për Ty lotojnë!
Që atëherë kur ndër ne, më s'të pamë;
Sikur Dielli na u shua e, rrugën lamë!

Sa herë pranvera vjen, zorshëm po bleron;
Malit, s'i shkrin bora, pa çka zemra i vlon!
Përmallshëm, t'malit zogi, rrallë këndojnë;
Qielit, tokës, shqipet t'lypin e, s'pushojnë!

Dirgjet lumi me përtësë, kënga s'i degjohet;
Legjendash, krehnikët dalin, n'Ty të takohen.
Mbetur bosh logu i mejdanit, hiç s'po ka nur;
Nepërkëmbur, pa Ty vatani, Enver, o burrë!

Heu sa mote, rrodhen iken, qyshë atëherë;
Pa Ty, erdhen, iken si pa u ndërë, o Enver!
Sa akuj ngrinë, lule u thanë e, prap ra bora;
Me të Nënës nder, luajnë sot, cuba e hora!

Të madh, lënë na e pate Ti, amanetin:
"Fort t'i ruani, tokën, qiellin dhe detin!
Historinë kem ndër to, varret e të parëv;
Gjak, ende kullojnë, trojet e shqiptarëve!"

Sot pyet bota e, n'habi, prap po bën seri;
Sa zemra n'gjoks, patur paske, Enveri?!
Se e gjithë bota, gdhihej, errej n'suferinë;
E, Shqipëria e Enver Hoxhës, me lavdinë!

Kur dhëmbët bushtërbota na i shtrengonte;
I yni greshëtbashkim, kuçedren e tmerronte!
Ndaj neshë, ka kusure botëliga për të larë;
Sa kohërat, tutje ikin, i yni gjak, i patharë!
Kurthe, sa herë ngriten e, na zunë prita;
Ëndrrave, sa Ty të shihnin, u binte pika!
Se ata, të paten parë, si luftove për liri;
Si vesa para dielli, para Teje çdo tradhti!

O sa ka sot, përse Ty, të kujtojë shqiptari;
Heronj e deshmorë, i shan, baltos tradhtari!
Se, pazare fshehtaz bëjnë, t'falin tokë e det;
Shpresëvrrarë, marrim arratinë, ç'i zi qamet!

Tash sa vite, si s'po gjën derman shqiptari;
Me vete thotë: - Çohu, Enver, dil nga varri!
Ngrihu, Ti o bir! N'dorë të ligut na lëshuan;
Jezitët, cubat, që për vend kurrë s'luftuan!

Parë kurrë, krejt ngjan vendi me karrakatinë;
Therje, vrasje, grabitje, 'han'- njeriu, njerin!
Ngrihet njëra palë: - Ta rrëzojmë qeverinë!
Hiç gajle s'kanë, flakë ta kallin Shqipërinë.

Këtë rracëkeqe politike, ç'dreq e polli;
Fëmijët e rininë, tërë në qafë, ç'na i mori!
"Turpërohet" çdo të enjte, i ziu Parlament;
Prej tyre, o popull, qyshë nuk zure mend?!

Ndaj, vargjet për Enverin, fshehur s'më rrinë;
Ato, kushttrim e flakë rrufeje, bëhen vetëtimë!
Pa Enverin, frikësohen ditët e, jeta dridhet;
Për Komb e Atdhe, burrë si Ti, më s'gjendet!

Për Ty Enver, vargun bombë, shkundi kohën;
N'agime shekujsh, si 'Grenuici', Ti për botën!
Në rrjete valësh, kushttrim vargu, piskamë lirie;
Flakërimë për Ty vargu, del zemre shqiptarie!

Sot, epidemia 'globalizëm', po dërgj botën;
Anicka, se prapa, historisë ia sjellin 'rrotën'!
Të ishe Ti, sytë të na i hapje n'kët' kohënxirë;
Mjaft pa Ty, po sheh ky popull, veç mënxyrë!

Na vënë kushte 'miqtë'tanë, t'falim tokë, det;
Po t'bëjmë si duan ata, na futin n'vathë të vetë.
Turr e vrap me sy mbyllë, o burra, atje t'hyjmë;
Pa Ty, o strateg, drejt humnerash po na shtypjnë!

I madhi peshk do t'na hajë, kush s'do t'na qajë;
Dhëlprra, dihet se mashtron, s'është ky faji i saj.
Porsi çjapi po na çojmë, me rresht, tek kasapi;
Pa Ty, Komb e Atdhe, në duar trapi e satrapi!

Ç'e ropen këtë vend, mish rreth kocke s'i lanë;
Tradhtinë, për vlerë, na e shesin, ca sharklatanë!
O Enver, të ishe Ti, hak të merrje për baterdinë;
Ndaj çakenjve në shtet, ta shpëtoje Shqipërinë!

Nga zemer e kësaj toke, del klithma: - O Enver!
- Dhe një herë, çohu o trim, vendin e bënë betër!
Plot të mira na dha natyra, na kthyen në mesjetë;
Rrojnë bosat si pashallarë e, populli ...vaj medet!

Mjerimi ka pllakosur, n'vatër t'popullit, 'mbret';
Sot prej tij, emrin fëmijës, i harron prindi i vetë!
Jargavitën zyberhanet, në dreka, darka e orgjira;
Pa Ty kjo, o Enver, quhet: 'Politikë faqenxira'!

Trashet e trashet, si s'u këput ky dreq zollumi;
Fakirët, veç lëpijnë buzët, zorrëbosh i zë gjumi!
Ata, 'fëmijët' e mjerimit, pëshqesh i kapitalit;
Viktimat e sistemit, pre e krimit dhe skandalit!

Të ishe Enver Ti, rrënjësh ç'i kishe shkulë;
Në jëtë njomëzat pa faj, çbani s'ish' ngulë!
Ndaj për Ty, varg i times muzë, çdo fije bari;
Shkronjat vezullojnë, 'rëndojnë' me vlera ari!

Nuk habitem, tek degjoj broçkulla për Ty;
Në Tëndën kohë, linda, u rrita e, çela sy.
S'ma shlyen kujtesen mua, asnjë 'tcuram';
Mbi moçalgënjeshtira, të verteten, mike kam!

I zhgarravituri sot, palo 'surrati' i botës;
Se sterrë, katran, e nxira zemer e kohës!
Genocide gjithandej, shfaroset njerëzimi;
Në pushtet, kuçedra, me specie nazizmi!

Për të botës popuj fole Ti, s'pate fare frikë;
Sa herë zërin ngrite, përmbi 'i', vure pikë!
Koha kurrë s'ta rrëzoi, fjalën, as mendjen;
Se mbushur dashuri, për liri, pate zemren!

Qerpiku s't'u dridh kurrë, hasmin e pe në sy;
Rrokulliset historia, n'zbrazëti vlerash, pa Ty!
Si metastaza kanceri, kapluar jeta prej partishë;
Liderët e tyre, s'do t'i beje, as çobenj dhishë!

Mbi dy dekada, popullgjori, porsi kali në lëmë;
Se me gënjeshtira plot, partibuçet e kanë dend'.
Mendjemarrë, i trullusur, në skamje mbingop!
Edhe era më e lehtë, t'mjerin e shemb për tokë!

Ah Enver! Si s'na pyete, bre, kur Ti na ike,
N'vetemi mbetem, me njerjë, që asaj dite?!
Si, kur han ujku mzorë, për ne s'ka mëshirë;
Lëmoshia që na japin, veç kocka për t'lëpirë!

Vjen i huaji, me ne tallet, mëngjesit, në darkë!
Keq u përmyten, për shpëtim, s'kemi 'varkë'!
Mirë na e bëjnë, me votat tona e rrëzuam veten;
Sa dhe tash, për karrige pushtash, vrasim veten!

Sa ishe Ti, o kryeburrë, Shqipëria pati zot;
Ishe e kohës frymë, e ushqeve lirinë në botë!
Ti u ngjite si shqiponjë, në majamalin e lavdisë;
Andej, Jotja dritëmendje, udhën ndrin shqip-tarisë!

Shpata Jote, kurrë s'u lakua, s'iu thye tehu;
Në prush betejash u kalit, aty veten e mprehu!
Në dorën Tëndë shpatë e kohës, çau errësirën;
Si askush, për Tëndin komb, bëre mrekullirën!

Sa shumë tutën, Ty ta kanë dhe sot, Enver;
Para Teje turpërohen, fundërrinat e pavlerë!
Se Diellin në mendje pate, Ti, na e le dritën;
Hiena, çakenj, Ty, sa t'kujtojnë, ato fëlliquen!


Me popullin gju më gju, koha Ty të ka parë;
Realitet, ç'ia bërë ëndrrat, me atë i pandarë!
Zuzarët i godite, s'i le shushunjat t'pinin gjak;
Për të gjitha paudhësitë, për popull more hak!

S'është përrallë, as gojëdhënë, Ti n'beteja fitimtar;
Ty lavdia pas të ndoqi, përëherë me Ty e pandarë!
Zgjove Kombin, mendjen ia ndrite si kurrë më parë;
Në 'Galaktikën' e shqiptarit, i shqiptarisë, Ti, fanar!

Me botën ç'do të ndodhte, veç Ti e parandjeve;
Njerëzimit i tregove, kurrë atë nuk e zhgënjeve!
'Xhandarin' nderkombëtar, me gisht e tregove;
Botës liridashëse, në dishepull, Ti iu shndërrove!

Vite, shekuj kapërceve, kohërat i pave larg;
Vlerat, urtësia, të ndiqnin gjithkund, varg.
Të gjurmoi kudo lavdia, dorën për ta dhënë;
N'qiej motesh emri Yt, ditën diell, natën hënë!

Lëmshmbledhura reshtëllungat, nxijnë qiellin;
Dritën s'ta shuajnë Ty, ishe, je, krah me Diellin!
Peshërëndë mendja Jote, s'mundi koha ta peshojë!
Sa herë Bota në udhëkryq, sytë, asajë t'i lëshojë!



Kohërat kanë zënë radhë, veç për Ty, o Enver;
Ndodhur s'pati kurrë, se mbetur kanë pa vlerë!
Krenar, me Ty Kombi, të mbolli ai në zemer;
Vetëtimë në qiej motesh, terrin çan, i Yti emer!

Ethet botën zënë, po këndellet nazi-fashizmi;
Që nga gjëma të shpetohet, duhet socializmi!
Që askush të mos guxojë, lirinë kujt t'ia cenojë;
Duhej gjallë të ishe Ti, kuçedra, t'mos kafshojë!

Për ty, Enver, n'rreze vargjet m'i kthen Dielli;
Për ty, Enver, më të bukurat llule i çel prilli!
Për Ty, Enver, lis më lis, ç'këndon bilbili;
Për Ty, Enver, ylberet n'valle, me rreze dielli!

Për Ty, Enver, ç'më derdhet shpirti në poezi;
Për Ty, Enver, s'më plakët vargu, gjithnjë i ri!
Për Ty, Enver, këndojnë zemrat përherë lavdi;
Për Ty, Enver, krenar Atdheu, kjo shqiptari!

Për Ty, Enver, kombi ynë kohërash mburret;
Për Ty, Enver, kurrë Shqipëria s'do të skuqet!
Për Ty, Enver, flet shqiptaria me zë prej burri;
Për Ty, Enver, më thellë lavdia, rrënjët i nguli!

Për Ty, Enver, pranverat çelin e, bleron jeta;
Për Ty, Enver, kurrë, Kombi s'bie në tatëpjeta!
Për Ty, Enver, s'do t'qajë kombi, do t'këndojë;
Për Ty, Enver, 'diell' i zemres, s'do t'përendojë!

Për Ty, Enver, sa herë ne do t'na marrë malli;
Diell agimesh, t'shohim Ty, mbi kreshta mali!
Për Ty, Enver, sa herë rracaa jonë të ndjejë 'uri';
Ty, t'thërret ajo e, Ti asaj, prap i vjen me lavdi!

Për Ty, Enver, frymojmë shqip, siç na deshe;
Jemi shkëmb i kësaj toke, s'jemi copa leckë!
Për Ty, Enver, me gjak tonë, kalanë mbrojmë;
Rrace, ne pa dalë fare, ligësisë s'ia lëshojmë!

Për Ty, Enver, idealin e mbroj tërë jetën;
Dritën na e dhe, për ta njohur të vertetën!
Të na mbytin, Enver, s'do t'i lëmë ferrat;
Se shtet s'bëjnë kurrë, çakenjtë, as derrat.

Për Ty, Enver, vargjet, kohërave ua falë;
E ato, flakë mbi re, asgjë driten s'ua ndalë!
Flakërimë e vargjeve, netët kall, n'zjarr i djeg;
Për Ty dashuria, vargjedritë, shteg më shteg!

E kanë kohërat nga një 'huq' ato, përherë;
Mos kujto se me Ty, u zemeruan, o Enver!
Se Ti kohës ia dhe dritën, mendjen Tëndë;
Atdhe, Komb e Liri, si tik - tak i një zemre!

Në dorë, djalli kohërat kur i merr, i çorodit;
Njeriu, njeriut, t'ia nxjerrë po dashka, sytë!
Bjerret shpirtnjerëzori, ngelet pa pikë vlerë;
Ç'vret e nxin kohëdjalli, se Ti s'je, o Enver!

E tmerron kohëkuçedren, heroizmi e lavdia;
Gjurmë mbi dhë, s'don t'u shohë kund, lubia!
T'thellat gjurmëlëna zemrave, nuk shlyen dot;
Rrojnë ato, sa t'ketë komb, sa të jetë kjo tokë!

Ndaj, Ty Enver, e Kombit zemer të ka Diell;
Andej na ndrin Ti, sa të ketë ujë, tokë e qiell!
Me bërllogje mbushur koha, ndotur historia;
S'mund të rrojnë në një vend, turpi e lavdia!

Me Ty n'zemer, Enver, ia mbyll kuçkës gojën;
Falë Tëndes dritë, ligësisë do t'ia nxjerr bojën!
Lindin, rriten në këto troje, kreshnikë e shqipe;
Rron Enver Legjenda, lëshon për ne rreze drite!

Kohërat kam shaluar, n'mugëtira, larg vrapuar;
Historinë me vete mora, një si Ti, për ta zbuluar.
Që nga, e kohëlashtës 'fëmijëri' e, deri më sot;
Fletëve të historisë, s'gjeta kund, si Ty, në botë!

Në daç nga nuri, urtësia, mendja, zemra, trimeria;
Para kolos Enverit, binte n'gjunjë, vetë 'Perendia'!
Bota çarmatosej para Tij, as se si s'e përballonte;
Se, t'veteta, liri, vlera, popujt mbarë, Ai mbronte!

Ndaj sot, këtij gjenjali, plakëbota i hedh baltë;
Mdryshe historia, Enverin e gdhend me daltë!
Me 'lotë' reptili qajnë, kryemalin s'e rrëzojnë;
